



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 4, datë 12.02.2015

**PËR
“MIRATIMIN E NJË SHITESË NË BUXHETIN E KLUBIT SPORTIV “TIRANA” PËR
DHËNIE STIMULI SPORTISTIT JURGEN ULDEDAJ PËR ARRITJE TË
REZULTATEVE TË LARTA SPORTIVE”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pikat 1 dhe 3/II, nenit 32 shkronja “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 1, datë 26.02.2014 për “Miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2014-2016 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014” (i ndryshuar):

V E N D O S I:

1. Të miratojë një shtesë në buxhetin e Klubit Sportiv “Tirana” për dhënie stimuli sportistit Jurgjen Uldedaj për arritje të rezultateve të larta sportive, shpalljen fitues i vendit të tretë (medalje bronxi) në Kampionatin Europian të Boksit për të rinj Rusi, Mars 2013 dhe shpalljen fitues i vendit të tretë (medalje bronxi) në Kampionatin Europian te Boksit për të rinj Kroaci, Tetor 2014, në strukturën dhe artikullin si më poshtë:

Gr.00. Tit. 08140. Artikulli 606 **400 000 lekë**

2. Efektet financiare të pikës 1 të vendimit të përballohen duke pakësuar Fondin Rezervë të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014, në të njëjtën shumë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Klubi Sportiv “Tirana”.
4. Ky vendim hyn në fuqi dhjetë ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

ALDRIN DALIPI